# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2021 – Numri: 39

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 12 mars 2021**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 19/2021, datë 15.2.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë"............................ | 4795 |
| Vendim i Kuvendit nr. 27/2021, datë 8.3.2021 | Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës"........................ | 4799 |
| Vendim i Kuvendit nr. 28/2021, datë 8.3.2021 | Për emërimin e zotit Olsi Çoku në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e kryetarit të Bordit........................................................................................ | 4802 |
| Vendim i Kuvendit nr. 29/2021, datë 8.3.2021 | Për emërimin e zotit Denar Biba anëtar i Komisionit të Konkurrencës.... | 4802 |
| Akt normativ nr. 6, datë 10.3.2021 | Për dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për zhvillimin e negociatave me prodhuesit, me distributorë të autorizuar, me qeveritë ose institucionet e autorizuara prej tyre, të vendeve që prodhojnë ose distribuojnë vaksina anticovid, për të siguruar këto vaksina, të cilat janë të certifikuara nga trupa certifikuese në vendin e prodhimit të tyre........................................................................................ | 4802 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 24.2.2021 | Për një ndryshim në vendimin nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese"............................................................ | 4803 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 10.3.2021 | Për largimin nga detyra të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura................................................................ | 4808 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 10.3.2021 | Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë........................................................................................ | 4808 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 10.3.2021 | Për kalimin në pronësi të Bashkive Durrës dhe Rrogozhinë të objekteve arsimore, shkolla 9-vjeçare "Neim Babameto", Bashkia Durrës, dhe shkolla 9-vjeçare "Gosë", Bashkia Rrogozhinë................. | 4809 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 10.3.2021 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në Bashkinë Lezhë................................................ | 4811 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 10.3.2021 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar , në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese.............................................................................................. | 4811 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 10.3.2021 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të çerdhes "Valias", në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese............................................................................................... | 4812 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 10.3.2021 | Për kalimin në pronësi të Bashkisë Shijak të njësive individuale të banimit…………………………………………………….................. | 4812 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 155, datë 3.3.2021 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 909, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh".............. | 4815 |
| Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 26.2.2021 | Për një shtesë dhe një ndryshim në udhëzimin nr. 4038, datë 4.9.2015 "Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër".......................... | 4816 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 56/2, datë 10.3.2021 | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për projektim, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve–Bypass Orikum –Dukat (Ura e Shën Elizës)"...................................................................... | 4816 |

**LIGJ**
**Nr. 19/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 173/2014 "PËR DISIPLINËN NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 pas fjalës "kursantët" shtohet fjala "studentët".

Neni 2

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
a) fjalia e fundit e shkronjës "b" ndryshohet si më poshtë:
"Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me përjashtim të atyre të përcaktuara në paragrafin e dytë të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni.";
b) në shkronjat "c" dhe "ç", pas fjalës "batalioni" shtohen fjalët "drejtuesi ushtarak në nivel njësie kryesore/njësie bazë në institucionet arsimore ushtarake";
c) në fund të shkronjës "c" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Komandantët e Forcave dhe strukturave mbështetëse, me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor, për masat shumë të rënda "Vërejtje me paralajmërim" dhe "Ulje në pagë" për tetarët dhe nëntetarët, si dhe për ushtarët me grada "Ushtar I" deri "Ushtar IV" në varësi të tyre.".
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Ndaj oficerëve me grada madhore mund të jepen vetëm masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "dh", sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.".

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 9, pas fjalëve "në Shtabin e Përgjithshëm" shtohen fjalët "Komandat e Forcave dhe strukturat mbështetëse".

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11
**Shkelje disiplinore të lehta**

1. Shkelje disiplinore të lehta janë:
a) veprimi në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve ose të materialeve shkresore, elektronike dhe filmike;
b) mosrespektimi i rregullave të nderimit sipas shkallës hierarkike;
c) mosdeklarimi i përdorimit të barnave për arsye mjekësore, që krijojnë efekte në sjelljen ose aftësitë fizike të tij;
ç) publikimi i paautorizuar në rrjetet sociale i pamjeve personale ose i çdo efektivi të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak, simbole dhe mjete teknike ushtarake;
d) mosrespektimi i orarit të punës;
dh) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura për qëllime private, gjatë apo pas kryerjes së detyrës, përjashtuar rastet kur është i autorizuar për këtë gjë;
e) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura pa dokumentacionin përkatës;
ë) përdorimi i paautorizuar i sendeve personale dhe ushtarake të ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;
f) përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private;

g) mosraportimi i shkeljes disiplinore;

gj) lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës ose mjetit tokësor, detar, ajror nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale;

h) përdorimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;

i) pranimi i dhuratave ose i ndonjë përfitimi nga vartësit apo persona të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

j) mosdhënia e ndihmës ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ata kanë nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet;

k) shkrepja e armës nga pakujdesia, e cila nuk shkakton dëme materiale ose lëndime njerëzore;

l) mosmirëmbajtja dhe/ose dëmtimi i armës, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura nga pakujdesia, që shkakton humbjen e përkohshme të gatishmërisë teknike të tyre.

2. Kryerja e shkeljes së tretë të lehtë disiplinore, pasi ushtaraku aktiv ka marrë dy masa disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet e rënda, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.”.

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

**Shkelje disiplinore të rënda**

1. Shkelje disiplinore të rënda janë:

a) kryerja e riteve fetare me uniformë në institucionet fetare, jashtë ambienteve të Forcave të Armatosura;

b) publikimi ose dhënia në medie e informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, si dhe shpërndarja e dokumenteve zyrtare të paklasifikuara, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

c) shprehja e kritikave publike ndaj Forcave të Armatosura, në formë shkresore, elektronike ose verbale, që cenon imazhin e institucionit apo personalitetin e ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;

ç) fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore ose elektronike;

d) dhënia me dashje e informacionit të gabuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

dh) shkelja me qëllim e rregullave të mbajtjes, të mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe të përdorimit të armatimit, të municionit, të teknikës, të pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura;

e) mbajtja dhe përdorimi i armës nga ushtaraku i Forcave të Armatosura në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

ë) mbajtja e armëve individuale private, me leje, në ambientet ushtarake;

f) veprime, qëndrime ose shfaqje diskriminuese në bazë etnie, fetare, race, krahine, bindjeje politike, filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore;

g) përdorimi i pijeve alkoolike gjatë punës/shërbimit apo në rastet kur është me uniformë, me përjashtim të aktiviteteve zyrtare;

gj)dhënia e uniformës me shenjat dhe simbolet dalluese ushtarake, e dokumentit të Forcave të Armatosura ose e pajisjeve të tjera ushtarake personave të tjerë;

h) mbajtja e uniformës ushtarake në lokale nate, kazino, lojëra fati dhe në ambiente të tjera të ngjashme me këto;

i) mungesa, mosparaqitja në shërbim/punë ose largimi nga vendi i shërbimit/punës, pa arsye të justifikuara deri në 5 (pesë) ditë për ushtarët dhe deri në 7 (shtatë) ditë për oficerët dhe nënoficerët;

j) mosparaqitja në punë ose në shërbim jashtë orarit të përcaktuar, kur i kërkohet nga eprorët e tij, pa arsye të justifikuara;

k) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;

l) ngacmimet seksuale në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale ose fizike të një natyre seksuale, të kryera gjatë ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbëjnë vepër penale;

ll) shkelja e rregullave të shërbimit, kur nuk përbën vepër penale;

m) rezistenca ndaj procedimit disiplinor ose refuzimi i kryerjes së masave disiplinore;

n) përkrahja ose ndihma në kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në këtë ligj ose pengimi apo parandalimi për kapjen, gjykimin a dënimin e ushtarakut, i cili ka kryer një shkelje të dënueshme nga ky ligj;

nj) mosmarrja e masave të nevojshme për ndërprerjen e shkeljes disiplinore që po kryhet nga vartësit e tij dhe/ose për parandalimin e pasojave të mëtejshme që mund të vijnë prej saj;

o) kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës;

p) dëshmia e rreme gjatë procedimit disiplinor;

q) mosraportimi i përdorimit të armës së zjarrit;

r) mosrespektimi i orarit të punës më shumë se një herë brenda një periudhe njëmujore;

rr) ushtrimi i presionit ndaj vartësve për përfitime personale, kur nuk përbën vepër penale;

s) prishja e qetësisë në njësi ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale;

sh) moszbatimi i detyrave të dhëna nga eprori i drejtpërdrejtë;

t) mbajtja në mënyrë të parregullt, ndryshimi ose keqpërdorimi i uniformës dhe shenjave ushtarake;

th) "Ngacmim" në çdo formë sjelljeje të padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues ose fyes për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjellje të tillë;

u) veprime me dashje, të cilat çojnë në paaftësi fizike të vetë ushtarakut, me qëllim shmangien nga detyrat e ngarkuara.

2. Shkeljet disiplinore të përcaktuara në shkronjat "c", "ç", "d", "k" dhe "l" të pikës 1 të këtij neni, të kryera gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes, misionit jashtë vendit ose të kryera nga oficerë me grada madhore, kategorizohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe masat përkatëse jepen sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

3. Kryerja e shkeljes së tretë të rëndë disiplinore, pasi ushtaraku ka marrë dy masa disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet shumë të rënda, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
**Shkelje disiplinore shumë të rënda**

Shkelje disiplinore shumë të rënda janë:

a) mbështetja e fushatës së një partie ose organizate politike apo e një anëtari të një partie politike ose të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë fizikisht ose duke kontribuar financiarisht;

b) ndihma, përkrahja ose pjesëmarrja në aktivitete të organizatave politike, fetare ose jofitimprurëse gjatë orarit të punës, në vendin e punës ose në mjetet ushtarake, si dhe në rastet kur mban uniformën ushtarake ose shenja të saj;

c) lejimi i personave nga organizata politike, fetare ose çdo organizatë tjetër jofitimprurëse të bëjnë propagandë në ambientet e Forcave të Armatosura dhe në mjetet që ata disponojnë;

ç) përdorimi, shpërndarja ose vendosja në mjetet ose në ambientet ku shërbejnë Forcat e Armatosura e simboleve apo reklamave të organizatave politike apo shoqërore, me përjashtim të atyre me karakter humanitar;

d) ushtrimi i funksioneve ose mospërmbushja e detyrave që sjellin cenim të operacionalitetit, të gatishmërisë dhe të sigurisë në Forcat e Armatosura;

dh) organizimi, nxitja ose pjesëmarrja në grevë;

e) përdorimi i substancave të paligjshme dhe i lëndëve narkotike, kur nuk përbën vepër penale;

ë) dhënia ose mundësimi i dhënies së informacioneve me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme, personave të paautorizuar ose medies, kur nuk përbën vepër penale;

f) ngacmimet në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale ose fizike të një natyre seksuale, të kryera nga eprori ndaj vartësit ose ndaj ushtarakut me gradë më të ulët gjatë ose jashtë orarit të punës;

g) organizimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;

gj)ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune, sjellja fyese ose kërcënuese ndaj një personi tjetër, kur kjo ushtrohet nga oficerët aktivë me grada të larta ose madhore të Forcave të Armatosura ose kur kryhet ndaj eprorit të drejtpërdrejtë në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;

h) refuzimi i zbatimit të urdhrit ose një vendimi të ligjshëm të dhënë nga eprori;

i) mosmarrja e masave të duhura të organizimit dhe të sigurisë nga drejtuesit e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura, kur kjo ka sjellë pasoja të rënda materiale;

j) përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin dhe/ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët, për çfarëdolloj arsyeje, pa dijeninë e tyre, kur nuk përbën vepër penale dhe përveç rasteve të parashikuara me ligj.”.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) “Stërvitje disiplinuese”, e cila është masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura brenda natyrës së elementeve të stërvitjes, të tilla si: vrapim, pompa, palosje ose ndonjë stërvitje tjetër të përshtatshme gjatë shërbimit. Kjo masë jepet ndaj ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve deri në gradën kapiten.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Masat disiplinore që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje shumë të rënda janë:

a) “Vërejtje me paralajmërim”, e cila është masa me shkrim, e motivuar, drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura për lirim nga Forcat e Armatosura;

b) “Ulje në detyrë”, që është një masë nëpërmjet së cilës ushtaraku emërohet në një detyrë të përcaktuar për t’u ushtruar nga një ushtarak me gradë më të ulët për jo më shumë se një vit;

c) “Ulje e pagës”, që është masë nëpërmjet së cilës ushtaraku do të trajtohet me pagën e deri një grade më të ulët për jo më shumë se një vit;

ç) “Ndalimi për gradim”, e cila është masa që ndalon ushtarakun për të konkurruar për marrjen e gradës së radhës vetëm 1 (një) herë;

d) “Ulje në gradë”, e cila është një masë nëpërmjet së cilës ushtaraku ulet deri në një gradë, për jo më shumë se 1 (një) vit. Në fund të periudhës së zbatimit të masës disiplinore, ushtaraku rimerr gradën e mëparshme, me urdhër të autoritetit përgjegjës;

dh) “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”, e cila është masë ekstreme e dhënë për shkelje shumë të rënda disiplinore.”.

Neni 8

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.”.

Neni 9

Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) shkronja “gj” ndryshohet si më poshtë:

“gj) Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes apo misionit jashtë vendit.”.

b) Pas shkronjës “gj” shtohen shkronjat “h”, “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

"h) kryerja e shkeljes disiplinore nga oficerë me grada të larta.

i) kryerja e shkeljes disiplinore në situatë lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

j) kryerja e shkeljes disiplinore gjatë operacioneve ose misioneve brenda vendit.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.".

3. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat "c", "ç", "d" dhe "dh" të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.".

Neni 10

Në fjalitë e fundit të shkronjave "a" dhe "b" të nenit 23 shtohen fjalët "me urdhër të autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore".

Neni 11

Në pikën 4 të nenit 25 pas fjalës "të rënda" shtohen fjalët "dhe shumë të rënda".

Neni 12

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 15.2.2021.

**VENDIM**
**Nr. 27/2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 43/2017 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS"**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 43/2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës", të ndryshuar, ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 8.3.2021.

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**



Lidhja nr. 2

**ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS, SHOQËRUAR ME KATEGORIZIMIN E PAGËS PËR ÇDO POZICION**

POZICIONINUMRI

**I. KRYETAR(1)**

**II. KOMISIONER(4)**

**III. KABINETI(3)**

Drejtor kabineti1

Këshilltar 1

Sekretar1

**IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM(1)**

**V. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE PRODHUESE(7)**

DrejtorII-b1
InspektorIII-a6

**VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE TË SHËRBIMIT/ JOPRODHUESE (7)**

DrejtorII-b1
InspektorIII-a**6**

**VII. DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE (7)**

DrejtorII-b1
InspektorIII-a**6**

**VIII. DREJTORIA JURIDIKE E INTEGRIMIT DHE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE(6)**

Drejtor II-b 1
Inspektor **5**

**IX. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT(10)**

Drejtor II-b1

*Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Buxhetit*
Përgjegjës sektori III-a1
Specialist burime njerëzore III-b1
Specialist financë/buxheti III-b1
Specialist protokoll/arkiv IV-a1
Shofer kl. IV (VKM nr.717, datë 23.6.2009, i ndryshuar)1
Punonjës pastrimi1
*Sektori i Komunikimit*
Përgjegjës sektori III-a1
Specialist komunikimi, trajnime marrëdhënie me jashtë III-b2

**Gjithsej:46 vetë**

**VENDIM**
**Nr. 28/2021**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT OLSI ÇOKU NË DETYRËN E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, QË DO TË MBAJË FUNKSIONIN E KRYETARIT TË BORDIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6 dhe 8 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Olsi Çoku emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Kryetarit të Bordit për periudhën e mbetur të mandatit të anëtarit të liruar nga kjo detyrë. Periudha e mbetur e mandatit përfundon në datën 12.9.2024.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 8.3.2021.

**VENDIM**
**Nr. 29/2021**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT DENAR BIBA ANËTAR I KOMISIONIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Denar Biba emërohet anëtar i Komisionit të Konkurrencës me një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 8.3.2021.

**AKT NORMATIV**
**Nr. 6, datë 10.3.2021**

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE ME PRODHUESIT, ME DISTRIBUTORË TË AUTORIZUAR, ME QEVERITË OSE INSTITUCIONET E AUTORIZUARA PREJ TYRE, TË VENDEVE QË PRODHOJNË OSE DISTRIBUOJNË VAKSINA ANTICOVID, PËR TË SIGURUAR KËTO VAKSINA, TË CILAT JANË TË CERTIFIKUARA NGA TRUPA CERTIFIKUESE NË VENDIN E PRODHIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
**Dhënie autorizimi për zhvillimin e negociatave**

Dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për zhvillimin e negociatave me prodhuesit, me distributorë të autorizuar, me qeveritë ose institucionet e autorizuara prej tyre, të

vendeve që prodhojnë ose distribuojnë vaksina anticovid, për të siguruar këto vaksina, të cilat janë të certifikuara nga trupa certifikuese në vendin e prodhimit të tyre.

Neni 2
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 112, datë 24.2.2021

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 80, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA KOMBINAT, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat bashkëlidhur vendimit nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| Pika | Koordinata X | Koordinata Y |
|---|---|---|
| 1 | 395748.9441 | 4574294.4529 |
| 2 | 395779.2948 | 4574284.8797 |
| 3 | 395809.8670 | 4574293.7199 |
| 4 | 396028.6278 | 4574409.5086 |
| 5 | 396261.0362 | 4574532.5210 |
| 6 | 396498.7777 | 4574658.3562 |
| 7 | 396712.2054 | 4574771.3222 |
| 8 | 396742.7390 | 4574796.3124 |
| 9 | 396773.2726 | 4574821.3026 |
| 10 | 396785.7753 | 4574847.4167 |
| 11 | 396781.2018 | 4574877.4952 |
| 12 | 396792.6368 | 4574883.6791 |
| 13 | 396804.0719 | 4574889.8629 |
| 14 | 396814.1135 | 4574880.4194 |
| 15 | 396817.9628 | 4574873.3015 |
| 16 | 396822.6467 | 4574868.4415 |
| 17 | 396834.7921 | 4574873.4075 |
| 18 | 396847.2127 | 4574862.1953 |
| 19 | 396859.6334 | 4574850.9831 |
| 20 | 396855.0772 | 4574827.5208 |
| 21 | 396856.3130 | 4574803.8680 |
| 22 | 396862.7551 | 4574786.1500 |
| 23 | 396869.4449 | 4574773.7317 |
| 24 | 396876.1347 | 4574761.3134 |
| 25 | 396882.2028 | 4574756.9369 |
| 26 | 396939.6107 | 4574755.4147 |
| 27 | 396990.8029 | 4574756.2609 |
| 28 | 396998.0431 | 4574756.7622 |
| 29 | 397122.5534 | 4574777.4654 |
| 30 | 397267.0024 | 4574801.4840 |
| 31 | 397424.0392 | 4574827.5957 |

| | | |
|---|---|---|
| 32 | 397535.9616 | 4574846.2059 |
| 33 | 397546.3283 | 4574820.0806 |
| 34 | 397556.6950 | 4574793.9553 |
| 35 | 397565.1237 | 4574778.1061 |
| 36 | 397575.0182 | 4574763.1281 |
| 37 | 397581.4613 | 4574758.7604 |
| 38 | 397586.2901 | 4574757.1692 |
| 39 | 397590.8593 | 4574754.9394 |
| 40 | 397594.9241 | 4574753.5303 |
| 41 | 397599.2235 | 4574753.6820 |
| 42 | 397610.0433 | 4574755.9252 |
| 43 | 397620.6234 | 4574759.1127 |
| 44 | 397626.5814 | 4574744.2634 |
| 45 | 397632.5393 | 4574729.4140 |
| 46 | 397622.3044 | 4574724.1858 |
| 47 | 397606.3759 | 4574715.6736 |
| 48 | 397603.6257 | 4574712.9603 |
| 49 | 397601.9293 | 4574709.4892 |
| 50 | 397600.1097 | 4574704.5893 |
| 51 | 397597.6264 | 4574699.9900 |
| 52 | 397596.1164 | 4574696.3393 |
| 53 | 397595.9310 | 4574692.3930 |
| 54 | 397605.2269 | 4574677.0771 |
| 55 | 397609.9454 | 4574659.7579 |
| 56 | 397614.1910 | 4574649.0583 |
| 57 | 397618.4367 | 4574638.3588 |
| 58 | 397626.3428 | 4574628.5018 |
| 59 | 397638.4209 | 4574624.7886 |
| 60 | 397649.4066 | 4574624.8688 |
| 61 | 397655.6199 | 4574610.5001 |
| 62 | 397655.6175 | 4574598.4998 |
| 63 | 397529.7403 | 4574599.9883 |

| | | |
|---|---|---|
| 64 | 397410.0786 | 4574599.1084 |
| 65 | 397335.8374 | 4574564.2357 |
| 66 | 397320.3245 | 4574482.7741 |
| 67 | 397345.7585 | 4574328.5200 |
| 68 | 397328.1912 | 4574328.5228 |
| 69 | 397316.8709 | 4574326.1588 |
| 70 | 397314.6725 | 4574327.6567 |
| 71 | 397230.1159 | 4574286.3126 |
| 72 | 397146.2885 | 4574243.5091 |
| 73 | 397094.1533 | 4574217.7408 |
| 74 | 397042.0181 | 4574191.9726 |
| 75 | 397056.4647 | 4574165.0353 |
| 76 | 397070.9113 | 4574138.0980 |
| 77 | 397038.9449 | 4574120.7674 |
| 78 | 397006.9785 | 4574103.4368 |
| 79 | 397017.8842 | 4574092.4174 |
| 80 | 397023.3489 | 4574082.6850 |
| 81 | 397000.0981 | 4574076.1354 |
| 82 | 396983.0628 | 4574067.2174 |
| 83 | 396991.9875 | 4574059.4811 |
| 84 | 396994.6967 | 4574054.1131 |
| 85 | 396988.5355 | 4574038.1928 |
| 86 | 396982.3744 | 4574022.2725 |
| 87 | 396961.7520 | 4574015.8928 |
| 88 | 396947.3453 | 4574007.1448 |
| 89 | 396942.7929 | 4574007.1448 |
| 90 | 396938.2405 | 4574007.1448 |
| 91 | 396925.5466 | 4574020.0897 |
| 92 | 396912.8528 | 4574033.0345 |
| 93 | 396894.3711 | 4574024.3588 |
| 94 | 396875.8894 | 4574015.6830 |
| 95 | 396874.8057 | 4574017.9916 |

| | | |
|---|---|---|
| 96 | 396873.7220 | 4574020.3002 |
| 97 | 396869.0179 | 4574020.3002 |
| 98 | 396864.3137 | 4574020.3002 |
| 99 | 396860.6306 | 4574028.7049 |
| 100 | 396853.8397 | 4574037.1095 |
| 101 | 396846.8679 | 4574039.3442 |
| 102 | 396839.8962 | 4574041.5789 |
| 103 | 396832.3253 | 4574040.6032 |
| 104 | 396824.7544 | 4574039.6276 |
| 105 | 396822.5405 | 4574048.8932 |
| 106 | 396820.3266 | 4574058.1587 |
| 107 | 396815.2285 | 4574058.1587 |
| 108 | 396810.1304 | 4574058.1587 |
| 109 | 396792.8598 | 4574052.4368 |
| 110 | 396775.5892 | 4574046.7148 |
| 111 | 396771.2215 | 4574046.6483 |
| 112 | 396766.8538 | 4574046.5818 |
| 113 | 396766.9128 | 4574050.9569 |
| 114 | 396766.9719 | 4574055.3320 |
| 115 | 396687.6573 | 4574054.5139 |
| 116 | 396597.5972 | 4574053.5848 |
| 117 | 396507.5643 | 4574052.6561 |
| 118 | 396428.2226 | 4574051.8376 |
| 119 | 396366.6267 | 4574045.8668 |
| 120 | 396313.1859 | 4574040.3559 |
| 121 | 396306.4523 | 4574039.2063 |
| 122 | 396300.1216 | 4574036.6404 |
| 123 | 396284.3632 | 4574027.1483 |
| 124 | 396274.5868 | 4574011.5648 |
| 125 | 396241.9736 | 4573885.7477 |
| 126 | 396231.7892 | 4573869.1983 |
| 127 | 396208.9316 | 4573860.3236 |

| | | |
|---|---|---|
| 128 | 396186.9420 | 4573868.0396 |
| 129 | 396175.5347 | 4573885.2798 |
| 130 | 396169.3854 | 4573902.7798 |
| 131 | 396161.2637 | 4573919.4561 |
| 132 | 396157.4958 | 4573921.9761 |
| 133 | 396153.2399 | 4573920.4156 |
| 134 | 396147.4269 | 4573913.3571 |
| 135 | 396142.4265 | 4573905.7014 |
| 136 | 396130.2494 | 4573912.6117 |
| 137 | 396118.0722 | 4573919.5219 |
| 138 | 396122.6359 | 4573928.7970 |
| 139 | 396126.6680 | 4573938.3152 |
| 140 | 396126.3971 | 4573946.3546 |
| 141 | 396120.2931 | 4573951.5935 |
| 142 | 396112.9722 | 4573953.6660 |
| 143 | 396105.5760 | 4573955.4516 |
| 144 | 396098.1799 | 4573956.9361 |
| 145 | 396090.7322 | 4573958.1347 |
| 146 | 396073.2983 | 4573960.3109 |
| 147 | 396055.8643 | 4573962.4871 |
| 148 | 396036.3276 | 4573966.7418 |
| 149 | 396013.1739 | 4573978.8019 |
| 150 | 395997.4881 | 4573993.5589 |
| 151 | 395984.6430 | 4574014.5039 |
| 152 | 395977.5596 | 4574030.8709 |
| 153 | 395970.4762 | 4574047.2379 |
| 154 | 395960.1502 | 4574065.8267 |
| 155 | 395946.3822 | 4574082.0320 |
| 156 | 395907.0449 | 4574116.3788 |
| 157 | 395867.7076 | 4574150.7255 |
| 158 | 395835.2000 | 4574179.0304 |
| 159 | 395802.6924 | 4574207.3353 |

| | | |
|---|---|---|
| 160 | 395777.9990 | 4574212.8486 |
| 161 | 395753.3055 | 4574218.3618 |
| 162 | 395743.9312 | 4574233.6530 |
| 163 | 395734.5569 | 4574248.9442 |
| 164 | 395740.0010 | 4574258.1668 |
| 165 | 395735.9110 | 4574268.0646 |
| 166 | 395728.8874 | 4574274.1802 |
| 167 | 395735.8080 | 4574284.3166 |
| 168 | 396522.1811 | 4574187.0174 |
| 169 | 396549.5618 | 4574132.1406 |
| 170 | 396576.9425 | 4574077.2639 |
| 171 | 396502.4637 | 4574076.5502 |
| 172 | 396427.9849 | 4574075.8364 |
| 173 | 396418.8721 | 4574075.3745 |
| 174 | 396364.7981 | 4574069.8019 |
| 175 | 396310.7240 | 4574064.2293 |
| 176 | 396294.2129 | 4574060.2810 |
| 177 | 396278.8284 | 4574053.1031 |
| 178 | 396259.3404 | 4574034.5507 |
| 179 | 396248.2504 | 4574010.0356 |
| 180 | 396220.2656 | 4573897.8506 |
| 181 | 396210.0887 | 4573889.4055 |
| 182 | 396199.7307 | 4573895.5957 |
| 183 | 396193.9029 | 4573916.2596 |
| 184 | 396191.2725 | 4573936.1480 |
| 185 | 396193.9848 | 4573946.2046 |
| 186 | 396198.3139 | 4573958.4148 |
| 187 | 396197.9051 | 4573971.3633 |
| 188 | 396197.8465 | 4573977.1606 |
| 189 | 396198.5329 | 4573979.4815 |

| | | |
|---|---|---|
| 190 | 396201.6154 | 4573986.3182 |
| 191 | 396210.3009 | 4574001.3293 |
| 192 | 396216.5448 | 4574009.4249 |
| 193 | 396246.7661 | 4574039.6286 |
| 194 | 396281.7138 | 4574064.2100 |
| 195 | 396401.9475 | 4574125.6137 |
| 196 | 397287.3219 | 4574481.2318 |
| 197 | 397270.9571 | 4574580.8682 |
| 198 | 397318.7982 | 4574604.7802 |
| 199 | 397416.2396 | 4574643.8761 |
| 200 | 397513.6809 | 4574682.9720 |
| 201 | 397520.6012 | 4574685.7486 |
| 202 | 397531.6114 | 4574689.0445 |
| 203 | 397542.8773 | 4574691.3178 |
| 204 | 397546.7402 | 4574691.2578 |
| 205 | 397550.3653 | 4574689.9219 |
| 206 | 397554.9345 | 4574687.6921 |
| 207 | 397559.7634 | 4574686.1009 |
| 208 | 397563.3657 | 4574684.4788 |
| 209 | 397566.2065 | 4574681.7332 |
| 210 | 397576.5553 | 4574666.3428 |
| 211 | 397584.5297 | 4574650.9060 |
| 212 | 397586.1194 | 4574646.8997 |
| 213 | 397584.4998 | 4574631.5730 |
| 214 | 397570.9040 | 4574624.3145 |
| 215 | 397488.8492 | 4574623.7111 |
| 216 | 397406.7944 | 4574623.1078 |
| 217 | 397314.3716 | 4574579.6948 |


KUFIRI I ZONËS PËR RINDËRTIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6 | ZONA KOMBINAT
LEGJENDA
POZICIONI NË TERRITORIN E BASHKISË TIRANË
BASHKIA TIRANË | DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT | SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT PËR RINDËRTIM

**VENDIM**
**Nr. 141, datë 10.3.2021**

## PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Elona Kana, anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, largohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 145, datë 10.3.2021**

## PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve, krijuar me vendimin nr.234, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Universitetit të Arteve".

2. Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënieje, veprimtarie akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik-shkencor, të njohjes së aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi.

3. UART-i organizohet dhe funksionon si një institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike-artistike.

4. Për efekt të mësimdhënies në funksion të procesit akademik, për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues, grada shkencore nuk përbën detyrim. Personelit akademik krijues dhe interpretues, me arritje të shquara artistike, i bëhet ekuivalentimi i aktivitetit artistik e krijues me punën kërkimore-shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, në shërbim të vlerësimit të performancës akademike vjetore. Ekuivalentimi bëhet me vendim të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it, miratuar nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

5. Figurat e shquara me një veprimtari të spikatur artistike, brenda dhe jashtë vendit, vetëm për efekt mësimdhënieje, pa gëzuar të drejta të tjera, thirren në UART të japin kontributin e tyre, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it.

6. Procedura për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik që thirren në UART bëhet, si më poshtë vijon:

a) pozicionet e lira të punës, për të cilat do të ftohen personel me arritje në veprimtaritë krijuese dhe interpretuese, miratohen me vendim të Senatit Akademik;

b) kërkesat për ekuivalentim vlerësohen nga një komision ad-hoc, i ngritur me vendim të Senatit Akademik të UART-it;

c) pas ekuivalentimit, komisioni ad-hoc paraqet listën e kandidatëve që u janë ekuivalentuar arritjet, duke i renditur sipas përcaktimeve në statutin e UART-it;

ç) rektori i UART-it, në bazë të pozicioneve të lira të miratuara nga Senati Akademik dhe të listës së kandidatëve të renditur nga komisioni ad-hoc, lidh kontratat njëvjeçare të punës.

7. UART-i përfaqëson një strukturë të integruar, e cila përbëhet nga njësi kryesore dhe njësi bazë, me veprimtari kërkimore artistike-shkencore.

8. UART-i gëzon status të veçantë lidhur me:

a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik. UART-i ofron edhe studime specializuese afatgjata, programe të formimit të vazhduar për fushat e edukimit artistik, si dhe programe studimi me karakter profesional në fushën e arteve;

b) punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kritereve të përcaktuara nga njësia bazë përkatëse e të miratuara nga rektori, që mbajnë parasysh vlerësimin e karrierës profesionale dhe artistike, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it;

c) të drejtën për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim përvoje dhe mobiliteti në procesin mësimor-artistik dhe shkencor me institucione të arsimit të lartë, institucione të kërkimit shkencor, persona juridikë publikë ose privatë, vendas apo të huaj. Niveli i bashkëpunimit përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet institucioneve;

ç) hartimin e kritereve dhe të testeve artistike të pranimit me konkurrim të kandidatëve për studentë në UART.

9. Statuti i UART-it miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim.

10. Ngarkohen Universiteti i Arteve dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 148, datë 10.3.2021

## PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE DURRËS DHE RROGOZHINË TË OBJEKTEVE ARSIMORE, SHKOLLA 9-VJEÇARE "NEIM BABAMETO", BASHKIA DURRËS, DHE SHKOLLA 9-VJEÇARE "GOSË", BASHKIA RROGOZHINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkive Durrës dhe Rrogozhinë, përkatësisht, të objekteve arsimore shkolla 9-vjeçare "Neim Babameto", Bashkia Durrës, dhe shkolla 9-vjeçare "Gosë", Bashkia Rrogozhinë, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Durrës e Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njësia Administrative | Niveli | Emërtimi | Tipologjia e Ndërhyrjes | Financimi i Ndërtimit | Siperfaqe (m²) | Vlera e Projekt Idesë | Vlera e projektit te zbatimit dhe ndërtimit | Vlera e Mbikëqyrjes | Vlera e koaludimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Durrës | Durrës | Durrës | 9-vjecare | Neim Babameto | Rindërtim | Buxhet GoA | 5,324.0 | 2,516,540.40 | 224,500,000.00 | 1,833,873.00 | 213,127.42 | 229,063,540.82 |
| 2 | Tiranë | Rrogozhinë | Gosë | 9-vjecare | Gosë | Rindërtim | Buxhet GoA | 3,200.0 | 1,263,489.20 | 110,100,100.00 | 1,152,685.00 | 125,363.29 | 112,641,637.49 |

**VENDIM**
**Nr. 149, datë 10.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKINË LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 114 502 272 (njëqind e katërmbëdhjetë milionë e pesëqind e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Lezhë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 150, datë 10.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS ADMINISTRATIVE, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR , NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 203 034 301 (dyqind e tre milionë e tridhjetë e katër mijë e treqind e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.
2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 40 606 860 (dyzet milionë e gjashtëqind e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.
3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 151, datë 10.3.2021**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË ÇERDHES "VALIAS", NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 82 267 780 (tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes "Valias", në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 16 453 556 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes "Valias", në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 152, datë 10.3.2021**

## PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHIJAK TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Shijak të 70 (shtatëdhjetë) njësive individuale të banimit, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| Nr. | Emër Mbiemër | Tipologjia | Sip. (m²) | Bashkia | Njësia Admin. | Vlera e objektit [LEKË] | Vlera e mbikëqyrjes [LEKË] | Vlera e kolaudimit [LEKË] |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjyle Mustafa Domi | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 2 | Besnike Tahir Xhixha | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 3 | Shpresa Hamit Zeza | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 4 | Mariana Haxhi Domi | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 5 | Hava Hasan Domi | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 6 | Mimoza Murat Lala | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 7 | Hysni Qazim Zeza | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 8 | Gezim Isuf Shquti | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 9 | Armelin Hamid Zeza | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 10 | Nazmi Kapllan Zeza | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 11 | Petrit Xheladin Voci | 1+1 | 70 | Shijak | Xhafzotaj | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 12 | Fredi Mustafa Smoqi | 2+1 | 80 | Shijak | Xhafzotaj | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 13 | Naxhije Osman Varaku | 2+1 | 80 | Shijak | Xhafzotaj | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 14 | Gazmend Adem banushi | 2+1 | 80 | Shijak | Xhafzotaj | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 15 | Fundim Ibrahim Shahini | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 16 | Lutfije Xhelal Voci | 1+1 | 70 | Shijak | Xhafzotaj | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 17 | Ymer Selim Lala | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 18 | Hamdi Jonuz Plaku | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 19 | Maliq Hamid Sijoni | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 20 | Flamur Osman Hoxha | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 21 | Ervis Shpetim Balla | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 22 | Emiljan Mustafa Arapi | 1+1 | 70 | Shijak | Xhafzotaj | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 23 | Nuri Hakik Leçini | 3+1 | 105.1 | Shijak | Xhafzotaj | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 24 | Ardian Said Guza | 2+1 | 80 | Shijak | Xhafzotaj | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 25 | Xhevded Veli Mema | 2+1 | 80 | Shijak | Xhafzotaj | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 26 | Avni Kasem Sherra | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 27 | Naim Fadil Ramaliu | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 28 | Vladimir Adraman Qoku | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 29 | Ramiz Imer Ramaliu | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | Musa Osman Luku | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 31 | Zyber Ymer Koni | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 32 | Ramazan Zenel Gjeci | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 33 | Lulzim Shaqir Herri | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 34 | Enver Qamil Koni | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 35 | Sabri Demir Leba | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 36 | Liman Ramazan Koni | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 37 | Cerciz Valedin Kociaj | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 38 | Ilir Beqir Herri | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 39 | Dylaver Limon Osmani | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 40 | Tahir Hamdi barreti | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 41 | Fatmir Ramazan Lela | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 42 | Emin Ramazan Metaliu | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 43 | Isuf Ibrahim Koni | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 44 | Zejnel Shaban Osmani | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 45 | Hajri Kalem Xhafa | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 46 | Enver Hamdi Rameta | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 47 | Artur Zeqir Koni | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 48 | Shkelqim Adem Koni | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 49 | Gjovalin Pjeter Marku | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 50 | Ali Haxhi Uku | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 51 | Besnik Hasan Rama | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 52 | Axhem Jonuz Mema | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 53 | Lutfije Daut Domi | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 54 | Isuf Shaqir Domi | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 55 | Qamil Haxhi Daci | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 56 | Nadire Kalem Domi | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 57 | Vahide Ymer Bala | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 58 | Lulzim Mahmut Domi | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 59 | Hysni Musa Voci | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 60 | Ruzhdi Bajram Dervishi | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 61 | Ferik Bajram Dervishi | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 62 | Zyhdi Shefqet Domi | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 63 | Xhevdet Shaban Domi | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 64 | Artan Fadil Xhixha | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 65 | Hamza Zylyf Lala | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 66 | Dilaver Rahman Verjoni | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 67 | Ismail Ramazan Verjoni | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 68 | Dritan Hasan Karreci | 3+1 | 105.1 | Shijak | Maminas | 3,090,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 69 | Sait Limon Verjoni | 1+1 | 70 | Shijak | Maminas | 2,095,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |
| 70 | Arian Bajram Uruci | 2+1 | 80 | Shijak | Maminas | 2,470,000 | 17,395.90 | 1,897.80 |

**VENDIM**
**Nr. 155, datë 3.3.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 909, DATË 18.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR PUNONJËSIT DHE ISH-PUNONJËSIT E RAFINERISË SË NAFTËS, BALLSH"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 909, datë 20.11.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut V, "Çështje të fundit", shifra "... 461 305 700 (katërqind e gjashtëdhjetë e një milionë e treqind e pesë mijë e shtatëqind) lekë ..." zëvendësohet me "... 478 646 660 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë ...".

2. Në aneksin 1, "Lista emërore e punonjësve/ish-punonjësve përfitues", bashkëlidhur vendimit, shtohen nënndarjet sipas listës emërore të punonjësve/ish-punonjësve, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

LISTA EMËRORE E PUNONJËSVE/ISH-PUNONJËSVE

| | | |
|---|---|---|
| 828 | Marinaqi | Rama |
| 829 | Fatmir | Robi |
| 830 | Majlinda | Velcani |
| 831 | Leonora | Resulaj |
| 832 | Ndertie | Pashaj |
| 833 | Hatixhe | Taraj |
| 834 | Fatmir | Balaj |
| 835 | Kujtim | Brahimaj |
| 836 | Tajar | Kurti |
| 837 | Adem | Brahimaj |
| 838 | Faruk | Hajro |
| 839 | Timotheo | Dhimlea |
| 840 | Miranda | Tahiraj |
| 841 | Përparim | Breshanaj |
| 842 | Lulo | Ferhataj |

| | | |
|---|---|---|
| 843 | Skënder | Canaj |
| 844 | Vasillaq | Nano |
| 845 | Vladimir | Ymeraj |
| 846 | Bujar | Ymeraj |
| 847 | Gjergji | Selmani |
| 848 | Ramadan | Malaj |
| 849 | Kastriot | Musaraj |
| 850 | Kastriot | Toska |
| 851 | Luan | Idrizi |
| 852 | Viktor | Zotaj |
| 853 | Tarzan | Myrselaj |

**UDHËZIM**
**Nr. 1, datë 26.2.2021**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4038, DATË 4.9.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE QË OFROHEN PA PAGESË PËR PERSONAT E VERBËR DHE PJESËRISHT TË VERBËR"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 28, të ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4038, datë 4.9.2015 "Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër", bëhet një shtesë dhe një ndryshim si më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, emërtimi: Shoqata/ën e të Verbërve në Shqipëri" të zëvendësohet me fjalët "...Shoqatat apo organizatat e regjistruara për të verbrit në Shqipëri...".

2. Pas pikës 9, të shtohet pika 9/1, me këtë përmbajte:

"9/1. Përfaqësuesi i shoqatës apo organizatës për të verbrit, përfituese e shërbimeve universale postare pa pagesë sipas këtij udhëzimi, paraqet në sportelin postar kopje të dokumentit të regjistrimit në gjykatë."

3. Ngarkohet ofruesi i shërbimit universal postar dhe AKEP-i për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
**Belinda Balluku**

**KËRKESË**
**Nr. 56/2, datë 10.3.2021**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për projektim, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve–Bypass Orikum –Dukat (Ura e Shën Elizës)".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3 858 048 (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyzet e tetë) lekë.

KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
**Erlis Hereni**

**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR " ORIKUM-DUKAT"**

| Nr. | PRONARI Emri | Atësia | Mbiemri | TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp) ZK | Nr. Pas. | Lloji Pas. | Sip. Totale (m2) | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË — Shpronësim tokë "arë" Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Shpronësim tokë "truall" Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Shpronësim tokë "pyll" Sip. (m2) | Çmimi (lekë/ m2) | Vlera (lekë) | Ndërtesë banimi (shtëpi) Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2) | Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2) | Vlera (lekë) | Ndërtesë jo banimi Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2) | Vlera sipas Preventivit (lekë) | Ndërtesë total Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2) | VLERA TOTALE (lekë) | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | HALO | | FISTI(DANAJ) | 1569 | 192/1 | ARE | 2400 | 181.3 | 204 | 36985.2 | | | | | | | | | | | | | 36985.2 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 2 | ARIZ | | JAZOJ | 1569 | 195/17 | ARE | 14000 | 953.4 | 204 | 194493.6 | | | | | | | | | | | | | 194493.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 3 | BEQIR | | JAZOJ | 1569 | 195/16 | ARE | 6000 | 400.8 | 204 | 81763.2 | | | | | | | | | | | | | 81763.2 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 4 | QAZIM | MUHAREM | NELO | 1569 | 280/8 | ARE | 1520 | 256.6 | 204 | 52346.4 | | | | | | | | | | | | | 52346.4 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 5 | VEXHI | MUHAREM | NELO | 1569 | 280/5 | ARE | 4200 | 684.2 | 204 | 139576.8 | | | | | | | | | | | | | 139576.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 6 | MEHMET MEXHAT | | MEHILLI MEHILLI | 1569 | 280/4 | ARE | 750 | 144.3 | 204 | 29437.2 | | | | | | | | | | | | | 29437.2 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 7 | FIRJAN | AMET | MEHILLAJ | 1569 | 280/3 | ARE | 750 | 151 | 204 | 30804 | | | | | | | | | | | | | 30804 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 8 | QANI | | MEHILLI | 1569 | 280/2 | ARE | 750 | 122.2 | 204 | 24928.8 | | | | | | | | | | | | | 24928.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 9 | BEJKO | | MEHILLAJ | 1569 | 280/1 | ARE | 750 | 261.5 | 204 | 53346 | | | | | | | | | | | | | 53346 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 10 | TAJAR | | KUTELAJ | 1569 | 307/4 | ARE | 5500 | 652.2 | 204 | 133048.8 | | | | | | | | | | | | | 133048.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 11 | SHTET | | | 1569 | 301/7 | ARE | 1900 | 161 | 204 | 32844 | | | | | | | | | | | | | 32844 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 12 | BEJKO | | MEHILLAJ | 1569 | 301/5 | ARE | 7650 | 253.2 | 204 | 51652.8 | | | | | | | | | | | | | 51652.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 13 | XHEBRO | | BEDINI | 1569 | 307/3 | ARE | 4780 | 583.7 | 204 | 119074.8 | | | | | | | | | | | | | 119074.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 14 | ZENEL | | BEDINI | 1569 | 307/2 | ARE | 4780 | 433.4 | 204 | 88413.6 | | | | | | | | | | | | | 88413.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 15 | FEJZI | | KUTELAJ | 1569 | 307/1 | ARE | 8550 | 1881.4 | 204 | 383805.6 | | | | | | | | | | | | | 383805.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 16 | METE | | KUTELI | 1569 | 359/2 | ARE | 13500 | 612.6 | 204 | 124970.4 | | | | | | | | | | | | | 124970.4 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 17 | SHTET | | | 1569 | 359/8 | ARE | 3390 | 391 | 204 | 79764 | | | | | | | | | | | | | 79764 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 18 | SHTET | | | 1569 | 359/9 | ARE | 3390 | 181.4 | 204 | 37005.6 | | | | | | | | | | | | | 37005.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 19 | FATOSH | | MEHILLI | 1569 | 352/1 | ARE | 3800 | 127.2 | 204 | 25948.8 | | | | | | | | | | | | | 25948.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 20 | IZET | | MEHILLI | 1569 | 352/2 | ARE | 2400 | 156.2 | 204 | 31864.8 | | | | | | | | | | | | | 31864.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 21 | DITURI KRENAR DIANA ALBANA AUREL | | MEHILLAJ MEHILLAJ CIPA BRAIMILO MEHILLAJ | 1569 | 352/3 | ARE | 4500 | 680.4 | 204 | 138801.6 | | | | | | | | | | | | | 138801.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 22 | QEMAL | | MEHILLI | 1569 | 352/4 | ARE | 3500 | 2280 | 204 | 465120 | | | | | | | | | | | | | 465120 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 23 | METE | | BOZHANI | 1569 | 362/6 | ARE | 19600 | 835 | 204 | 170340 | | | | | | | | | | | | | 170340 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 24 | LEFTER | | BOZHANI | 1569 | 362/5 | ARE | 9350 | 1123.1 | 204 | 229112.4 | | | | | | | | | | | | | 229112.4 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 25 | LAVDOSH | NEIM | DULE | 1569 | 360/12 | ARE | 15840 | 2097.2 | 204 | 427828.8 | | | | | | | | | | | | | 427828.8 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 26 | RUSHIT | | CELO | 1569 | 360/11 | ARE | 9500 | 2006.3 | 204 | 409285.2 | | | | | | | | | | | | | 409285.2 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 27 | RUSHIT | | CELO | 1569 | 410/7 | ARE | 5500 | 695.1 | 204 | 141800.4 | | | | | | | | | | | | | 141800.4 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 28 | QEMAL | | MEHILLI | 1569 | 410/3 | ARE | 2500 | 135.4 | 204 | 27621.6 | | | | | | | | | | | | | 27621.6 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 29 | ARMAND | CANO | MEHILLAJ | 1569 | 410/1 | ARE | 540 | 74.6 | 204 | 15218.4 | | | | | | | | | | | | | 15218.4 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 30 | SHTET | | | 1569 | 410/10 | ARE | 600 | 88.8 | 204 | 18115.2 | | | | | | | | | | | | | 18115.2 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 31 | IZET | | MEHILLI | 1569 | 410/5 | ARE | 1800 | 151 | 204 | 30804 | | | | | | | | | | | | | 30804 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| 32 | DITURI KRENAR DIANA ALBANA AUREL | | MEHILLAJ MEHILLAJ CIPA BRAIMILO MEHILLAJ | 1569 | 410/4 | ARE | 3300 | 156.5 | 204 | 31926 | | | | | | | | | | | | | 31926 | Konfirmuar ASHK Vlore |
| | **SHUMA** | | | | | | | | | *3858048* | | | | | | | | | | | | | *3858048* | |

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 39
Datë: 2021/03/12 14:02:10
6a2976cc-d76d-4731-b979-a147009a99f7

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë